

Në pajtim me nenin 3 të Vendimit për përcaktim të lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane – objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparateve të tjera në Parkun e qytetit në Shkup (“Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 1/21), Kryetari i Qytetit të Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për përcaktimin e mënyrës, kushteve dhe procedurës për përdorimin e lokacioneve për instalimin e pajisjeve urbane në Parkun e Qytetit në Shkup

1. Lënda

Lënda e thirrjes publike është përcaktimi i mënyrës, kushteve dhe procedurës për përdorimin e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane dhe aparateve të tjera të lëvizshme në Parkun e qytetit në Shkup.

Pajisja urbane do të vendoset në 28 lokacione në Parkun e qytetit.

Lokacionet janë të përcaktuara në shtojcën grafike që është pjesë përbërëse e vendimit për përcaktimin e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane – objekteve të lëvizshme, aparateve të lëvizshme dhe aparateve të tjera në Parkun e qytetit Shkup.

Me objekte të lëvizshme nënkuptohen objektet që janë me motor me lëvizje të pavarur ose rimorkio që nuk posedon motor për lëvizje, përkatësisht automjetet e specializuara për shitje në rrugë, me gjatësi deri në 4 metra dhe me lartësi deri në 3 metra në të cilat mund të ofrohen shërbime të konfeksionuara hotelerie që nuk kanë ndikime negative ekologjike mbi mjedisin (shfrytëzojnë agregate për furnizimin me energji elektrike, me zhurmë të ulët, me cilësi të lartë, nuk posedojnë agregate industriale dhe posedojnë certifikatë se posedon emetime të ulëta të gazrave të dëmshëm).

Sipërfaqja maksimale e lokalitetit në të cilin vendoset pajisja urbane është deri më 16 m², në të cilën është e përfshirë objekti i lëvizshëm, përkatësisht aparati i lëvizshëm ose aparate të tjera, hapësira për manipulime, pajisja urbane në funksion të shfrytëzimit të lokalitetit – kosha për mbeturina.

1. Kushtet

1. Pajisjet urbane – objektet e lëvizshme, aparatet e lëvizshme dhe aparatet e tjera, të vendosura në një lokalitet të përcaktuar, mund të shfrytëzohen vetëm për shitjen e akulloreve (frigoriferët për akullore), pije, prodhime konditore, përgatitjen e kokoshkave, pambuk sheqeri, petulla të ëmbla dhe prodhime të ngjashme.
2. Objektet e vendosura, aparatet e lëvizshme dhe veglat nuk duhet të përmbajnë audio- sisteme për lëshimin e muzikës.
3. Në pajisjet urbane mund të vendosen mbishkrime reklamuese të cilat nuk janë më të mëdha se dimensionet e pjesës së parme të objektit në të cilin vendosen dhe me dimensionet e tyre (lartësia dhe gjerësia) janë pjesë përbërëse e dimensioneve të përgjithshme të objektit.

4. Në lokacionet në parkun e qytetit mund të vendosen objekte të lëvizshme, aparate të lëvizshme dhe aparate të tjera të lëvizshme të cilat kanë dizajn dhe pamje që nuk e prishin ambientin përreth ku janë vendosur.
5. Pajisjet urbane nuk mund të përdoren për shitjen e farave dhe prodhimet në formë arrash.
6. Subjekti i përzgjedhur është i detyruar që të paguaj taksën komunale në pajtim me dispozitat në fuqi.
7. Aplikuesi duhet të posedojë vendbanimin në territorin e Qytetit të Shkupit (komunat: Aerodrom, Gazi Babë, Kisella Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj) dhe të ketë regjistruar veprimtari në regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Korniza kohore

1. Lokalitetet në të cilat janë të vendosura pajisjet urbane – objektet e lëvizshme dhe veglat tjera jepen në shfrytëzim për periudhën nga 1 marsi deri më 30 nëntor të vitit në vijim.

4. Procedura

1. Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë të gjithë personat juridikë të interesuar për shfrytëzimin e lokalitetit në Parkun e qytetit – pjesa e parë dhe e dytë për vendosjen e pajisjeve urbane – objekte të lëvizshme, aparatet të lëvizshme dhe aparate të tjera për shitjen e akulloreve, pijeve dhe prodhimeve të tjera, përgatitjen e kokoshkave, pambuk sheqerit, petullave të ëmbla dhe prodhime të tjera të ngjashme.
2. Së bashku me kërkesën për shfrytëzimin e lokalitetit për vendosjen e objektit të lëvizshëm, duhet të dorëzohet:
 - Fotokopja e letërnjoftimit të vlefshëm si dëshmi se personi është banor i qytetit të Shkupit.
 - Deklaratë për pagesën e shumës monetare për mbulimin e shpenzimeve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqes publike që shfrytëzohet për vendosjen e objektit të lëvizshëm për periudhën nga 1 marsi deri më 30 nëntor të vitit në vijim.
 - Dëshmi për posedimin e aparatit fiskal.
 - Dëshmi për veprimtarinë e regjistruar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
 - Shtojcën grafike – skicë me dimensione të sakta të objektit të lëvizshëm, dhe lokacionin e kërkuar si dhe pamjen e pajisjes urbane e cila vendoset.
3. Pas marrjes së lejes për vendosjen e pajisjes urbane – objekteve të lëvizshme, të lidhet kontrata me NP “Higjiena komunale” dhe të dorëzohet Aktvendimi për regjistrimin e objektit të lëvizshëm, i dhënë nga Agjencia

për Ushqime dhe Veterinari në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të lejes, si dhe të paguhet obligimi ndaj NP “Parqe dhe Gjelbërime” për pastrimin e hapësirave publike për vendosjen e pajisjeve urbane në përputhje me Listën e çmimeve për shërbime për kryerjen e aktiviteteve të jashtëzakonshme të NP “Parqe dhe Gjelbërime”.

4. Subjekteve të interesuara të cilat plotësojnë kushtet nga pika 2 do t’u lejohet shfrytëzimi i lokacionit për vendosjen e objekteve të luajtshme në përputhje me parimin “I pari i ardhur, i pari shërbehet”;
5. Nëse subjekti kërkon që t’i miratohet lokacioni për vendosjen e objektit të luajtshëm, para 1 marsit, dhe pas 30 nëntorit, në përputhje me Vendimin për Rregullin Komunal mundet përkohësisht (gjatë kohës së mbajtjes së manifestimeve) të marrë leje.
6. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 10 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes publike në gazetata ditore.
7. Kërkesa, deklarata dhe paraqitja grafike mund të merren në Arkivin e Qytetit të Shkupit dhe barakën numër 11, zyra numër 1, bul. Ilinden nr. 82, 1000 Shkup
8. Lokacionet për vendosjen e pajisjeve urbane do të vendosen në koordinata, në portalin zyrtar të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Pika	X	Y
1- ushqim dhe/ose pije	7535438.90489	4651128.47380
2- ushqim dhe/ose pije	7535458.42607	4651155.66079
3- ushqim dhe/ose pije	7535481.02881	4651186.58836
4- ushqim dhe/ose pije	7535503.84966	4651213.45072
5- ushqim dhe/ose pije	7535407.57848	4651281.10329
6- ushqim dhe/ose pije	7535514.49053	4651285.02619
7- ushqim dhe/ose pije	7535448.92160	4651330.21173
8- ushqim dhe/ose pije	7535423.66808	4651358.55134
9- ushqim dhe/ose pije	7535186.89269	4651308.87201
10- ushqim dhe/ose pije	7535228.63899	4651398.63805
11- ushqim dhe/ose pije	7535290.21252	4651475.49073

12- ushqim dhe/ose pije	7535323.64558	4651529.86258
13- ushqim dhe/ose pije	7535271.28098	4651576.93000
14- ushqim dhe/ose pije	7535254.19401	4651595.94521
15- ushqim dhe/ose pije	7535234.69122	4651603.75411
16- ushqim dhe/ose pije	7535353.79921	4651744.14574
17- ushqim dhe/ose pije	7535218.74113	4651609.75626
18- ushqim dhe/ose pije	7534814.14470	4651713.88798
19- ushqim dhe/ose pije	7534848.12492	4651894.51387
20- ushqim dhe/ose pije	7534656.92687	4651778.47767
21- ushqim dhe/ose pije	7535513.67629	4651049.57489
22- ushqim dhe/ose pije	7535319.58659	4651531.78989
23- ushqim dhe/ose pije	7535151.29219	4651621.38009
24- ushqim dhe/ose pije	7535157.11304	4651815.05548
25- ushqim dhe/ose pije	7534971.78527	4651928.61928
26- ushqim dhe/ose pije	7534727.64880	4651931.33310
27- ushqim dhe/ose pije	7535371.64483	4651422.20934
28- ushqim dhe/ose pije	7535628.84395	4651255.34635

Koordinatat janë në Sistemin e koordinatave shtetërore të Maqedonisë

*Për 28 lokacionet e theksuara, mund të aplikohet më së shumti për 3 (tri) lokacione

*Aplikuesi mund të marrë leje për më së shumti 2 (dy) lokacione automjete.

*Leja mund të anulohet nëse aplikuesi nuk depoziton dokumentet nga pika 4 pika nënpika 3.

9. Kërkesa me dokumentacionin e plotë nga pika 4, nënpika 2 duhet të dorëzohet nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, pranë Sektorit për punë komunale, me shënimin – Thirrje publike për shfaqjen e interesit për përdorimin e lokacioneve për vendosjen e pajisjeve urbane në Parkun e qytetit – Shkup .

10. Ngarkohet kryetari i Qytetit të Shkupit të formojë Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike

11. Subjektet e interesuara që marrin pjesë në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet e procedurës së realizuar më së shumti deri në 10 ditë nga dita e skadimit të afatit për dorëzimin e aplikimeve.

*Arkivi i Qytetit të Shkupit gjendet në adresën bul. Ilinden nr.82, 1000 Shkup

Kontakt: Sektori për punë komunale
tel: 02/3297-389

QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT